



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2021:226074

Datë: 30.08.2022

Numri i dokumentit: 03370623

C.nr.1004/2021

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari **Besmir Juniku**, në çështjen juridike të paditësit L. K. nga fshati Rogovë, Komuna e Gjakovës, të cilin me autorizim e përfaqëson av. D. M. nga Prizreni, kundër të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimeve -''BKS'' me seli në Prishtinë, me bazë juridike – kompensim dëmi, vlera e kontestit 1,000.00 €uro, jashtë shqyrtimit gjyqësor, me datë **30.08.2022** merr këtë:

A K T V E N D I M

Padia e paditësit- L. K. nga fshati Rogovë, Komuna e Gjakovës, në lidhje me këtë çështje juridike **KONSIDEROHET E TËRHEQUR**.

A r s y e t i m

Paditësi L. K. nga fshati Rogovë, Komuna e Gjakovës, të cilin me autorizim e përfaqëson avokat D. M. nga Prizreni, pranë kësaj gjykate ka ushtruar padi kundër të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimeve''BKS'' me seli në Prishtinë, me bazë juridike – kompensim dëmi.

Paditësi me parashtresën e datës 07.10.2021 e ka tërhequr padinë ndaj të paditurës së lartcekur, pasi që është bërë zgjerimi i padisë në një lëndë tjetër, e për këtë çështje nuk ka interes juridik për vazhdimin e procedurës.

Gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, duke pas parasysh edhe tërheqjen e padisë ka ardhur në përfundim se padia e paditësit të konsiderohet e tërhequr në kuptim të nenit 261.1 të LPK-së, i cili e përcakton se *“261.1 Paditësi mund ta tërheqë padinë pa pëlqimin e të paditurit deri në momentin në të cilin i padituri e paraqet në gjykatë përgjigjen në padi...”*.

Nga arsyet e cekura më lartë gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 261. 1 lidhur me nenin 387.1 pika c) të LPK –së.

Numri i lëndës: 2021:226074
Datë: 30.08.2022
Numri i dokumentit: 03370623

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC,
C.nr.1004/21, me datë 16.08.2022.**

**Gj y q t a r i
Besmir Juniku**

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa konform nenit 261.4 të LPK-së.